

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 02-30

Data/Datum/Date: 12 / 01 / 20 23

Shtojca/Dodaci/Annex: (5)

PRISHTINË/A



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit: 02/481

Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.: 54/2023

Nr. i faqeve Broj stranica No. pages: 3

Data Datum Date: 12, 01 / 20 23

Hyrëse PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES TË

MINISTRISË SË FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE

DHE

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Marrë parasysh ndryshimet e sjella nëpërmjet Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, lidhur me bartjen e shërbimeve sociale dhe familjare nga Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes në MFPT në Departamentin e Shërbimeve në MD (me kodet e programeve 37850, 01500 dhe 01900), nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për në Ministrinë e Drejtësisë, palët lidhin këtë marrëveshje të bashkëpunimit, me qëllim të rregullimit të procedurave të bartjes, në mbështetje të nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Palët e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi janë:

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) e përfaqësuar nga Zv. Sekretari i Përgjithshëm z. Enis Spahiu,

dhe

Ministria e Drejtësisë (MD), e përfaqësuar nga Zv. Sekretarja e Përgjithshme, znj. Anita Kalanderi.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit është bartja/kalimi i përgjegjësi të menaxhimit të Departamentit të Shërbimeve (Departamenti) nga MFPT në kuadër të MD-së, si dhe rregullimi i ndërveprimit të dy ministrive deri në bartjen e plotë të përgjegjësi.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

Objekt i kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit është Departamenti (me kodet e programeve 37850, 01500 dhe 01900).

Neni 3

Obligimet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

1. MFPT ia siguron MD-së listën e pagave të zyrtarëve të Departamentit brenda (5) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.
2. MFPT ofron dhe transferon në MD dokumentacionin dhe dosjet në formë fizike dhe elektronike, për stafin e Departamentit, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

3. MFPT përgatit një raport për gjendjen e pasurisë së Departamentit dhe nxjerr raportet e pasurisë për secilin zyrtar, dhe në bashkëpunim me MD bën transferin e këtyre pasurive nga MFPT në MD, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.
4. MFPT ofron një listë të kontratave të prokurimit të nënshkruar për nevojat e Departamentit, dhe i mundëson MD-së që nga kontratat e nënshkruara të vazhdohet me realizimin e kërkesave dhe furnizimeve për nevoja të këtij Departamenti, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.
5. MFPT ofron dhe dorëzon MD-së një listë të obligimeve dhe faturave të cilat nuk kanë arritur të ekzekutohet nga buxheti i vitit 2022, për shkak të mbylljes së afateve të pagesave dhe për shkak se pranimi i disa furnizimeve apo blerjeve është realizuar gjatë muajit dhjetor/2022, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.
6. MFPT ofron MD-së kornizën e akteve ligjore dhe nënligjore, mbi bazën e të cilave duhet të vazhdojë punën dhe ofrimin e shërbimeve ky Departament, si dhe të gjitha draftet e punës që akteve ligjore dhe nënligjore të cilat kanë qenë në proces të plotësimit/ndryshimit, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.
7. MFPT do të asistojë kurdo që paraqitet ndonjë kërkesë nga MD, lidhur me procesin e bartjes dhe funksionimin e këtij Departamenti.

Neni 4

Obligimet e Ministrisë së Drejtësisë

1. MD siguron që lista e pagave e pranuar sipas pikës 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje të vendoset në sistemin e pagave për pagat e muajit Janar 2023, më së largu deri në fund të muajit Janar të vitit 2023.
2. MD shfrytëzon të gjitha kontratat aktuale në fuqi për realizimin e kërkesave, furnizimeve apo blerjeve për nevoja të këtij Departamenti dhe se të gjitha obligimet të dala nga realizimi i këtyre kërkesave ekzekutohet nga buxheti i aprovuar dhe kodet e programeve të këtij Departamenti.
3. MD në bashkëpunim me këtë Departament identifikon dhe angazhohet në iniciimin e procedurave të reja të prokurimit për shërbime, furnizim apo blerje të reja si dhe bëje përgatitjet për iniciimin e procedurave për kontratat që do të skadojnë nga janari/2023, duke vendosur këto në Planin e Prokurimit të MD-së.
4. MD merr përsipër të gjitha obligimet ligjore dhe procedurale të inicuar apo të dakorduara nga MFPT para datës 01.01.2023 (procedura lidhur me marrëdhënien e punës, procedura lidhur me çështjet disiplinore, obligimet nga planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Avokati i Popullit si dhe obligime të ngjashme).

5. MD obligohet të zbatojë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe vendimet e institucioneve të nivelit lokal apo qendror, për vlerësimin profesional dhe vendosjen e tyre në këtë Departament, deri në ndryshimet ligjore që mund të përcaktojnë ndryshe mënyrën e vlerësimit dhe vendosjes në këtë Departament.

6. MD do të bashkëpunojë me institucionet tjera përgjegjëse të nivelit qendror sa i përket zhvillimit të politikave, standardeve dhe strategjisë për shërbimet që do të ofrohen nga ky Departament.

7. MD do të bashkëpunojë me institucionet e nivelit komunal dhe qendror për mënyrën e zbatimit të mbikëqyrjes, monitorimit dhe inspektimit të ofrimit të shërbimeve nga ky Departament.

8. MD obligohet që brenda muajit janar/2023 të inicoj dhe themeloj, Komisionin e Licencimit të OJQ-ve, Komisionin e Ankesave të shkallës së II-të për shërbime sociale dhe familjare, Komisioneve tjera përkatëse, Panelit për Strehim Familjar dhe Adoptim dhe Keshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 5 **Periudha transitore**

1. Palët e kësaj Marrëveshjeje pajtohen që periudha transitore për bartjen e tërësishme të menaxhimit të këtij Departamenti është data 30.06.2023.

2. Përgjatë kësaj periudhe transitore, MD mund të kërkojë nga MFPT realizimin e pagesave të caktuara, të cilat për shkak të planifikimit buxhetore nuk mund të realizohen nga MD. Kërkesat e tilla duhet të jenë të arsyetuara

3. Përgjatë kësaj periudhe transitore, MFPT mund të kërkojë nga MD po ashtu realizimin e disa pagesave për shërbimet që janë në shfrytëzim të stafit të transferuar në MD.

Neni 6 **Mosmarrëveshjet**

1. Çdo kontest apo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhet në frymë bashkëpunimi dhe me qëllimin e përbashkët të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Republikës së Kosovës.

2. Në rast të krijimit të rrethanave të reja, palët me dakordim të dyanshëm mund të lidhin aneks-marrëveshjeje për adresimin e rrethanave të reja.

Neni 7
Personat përgjegjës për zbatim të marrëveshjes

1. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, pajtohen që të caktojnë personat përgjegjës të autorizuar për komunikim ndërmjet tyre lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshje, si vijon:

- 1.1 Për MD – Lulzim Beqiri Drejtor DIEKP
- 1.2 Për MFPT – Mentor Morina Udhëheqës i DPSF

Neni 8
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

- 1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.
- 2. Kjo marrëveshje mbetet në fuqi deri në transferimin e plotë të përgjegjësisë nga MFPT për në MD, por jo më larg se 01.01.2024.
- 3. Kjo marrëveshje mirëkuptimi është e nënshkruar në katër (4) kopje origjinale, nga dy (2) për secilën palë nënshkruese.

Palët nënshkruese:

Enis Spahiu
Zv. Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve



Anita Kalanderi
Zv. Sekretare e Përgjithshme
Ministria e Drejtësisë



Prishtinë, më 12 . 01 .2023